

20251423156

Në bazë të nenit 105, paragrafi (3) dhe nenit 112, paragrafi (5) të Ligjit të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018 dhe 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/2019, 103/2021, 86/2025 dhe 114/2025) dhe të nenit 131 paragrafi (3) dhe nenit 138 paragrafi (5) të Ligjit të Financimit Kapital të Sigurimit Vullnetar Pensional (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 103/2021), Këshilli i ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, në mbledhjen e mbajtur më 30.6.2025, miratoi

RREGULLORE PËR INVESTIM TË MJETEVE NË FONDET PENSIONALE

I Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen më detajisht:

- a) kushtet që duhet të plotësojnë tregjet e rregulluara sekondare të kapitalit ku tregtohen mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (në tekstin e mëtejshëm: fondet pensionale);
- b) cilësia e aksioneve, obligacioneve dhe instrumenteve të tjera në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale;
- c) shtetet ose grupet e shteteve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale; dhe
- ç) transferimi i menaxhimit të mjeteve të një fondi pensional te një menaxher asetesh me seli jashtë shtetit.

Neni 2

Me mjetet e fondeve pensionale nuk duhet të fitohen instrumente mbi të cilat janë vendosur ndalime ose kufizime të çfarëdo lloji.

Me mjetet e fondeve pensionale nuk duhet të mbahen “pozicione të shkurtra” (short selling), përkatësisht të huazohen instrumente financiare që janë në pronësi të fondeve pensionale.

Neni 3

Detyrimet për transferimin e letrave me vlerë, që lindin nga transaksionet me letra me vlerë në të cilat marrin pjesë fondet pensionale, realizohen me dorëzimin e njëkohshëm të letrave me vlerë dhe pagesën e çmimit për letrat me vlerë, në përputhje me parimin “dorëzim përkundrejt pagesës”.

Me mjetet e fondeve pensionale nuk duhet të kryhet tregtim i instrumenteve financiare nëpërmjet transaksioneve “bllok”.

II. Kushtet që duhet t’i plotësojnë tregjet e rregulluara sekondare të kapitalit ku tregtohen mjetet e fondeve pensionale

Neni 4

Në pajtim me nenin 105, paragrafi (2) të Ligjit të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional dhe nenin 131, paragrafi (2) të Ligjit të Financimit Kapital të Sigurimit Vullnetar Pensional, tregtimi me mjetet e fondeve pensionale kryhet në tregje të rregulluara sekondare të kapitalit dhe në tregje nëpërmjet sportelit të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

Shoqëria që menaxhon fondin pensional mund të:

- a) lidhë marrëveshje për shitblerjen e aksioneve në pronësi të fondit pensional në rast të marrjes së shoqërisë aksionare nëpërmjet një oferte publike për blerje;
- b) blejë aksione të lëshuara nga shoqëri aksionare që i plotësojnë kushtet e kësaj rregulloreje, në ofertë publike;
- c) blejë letra me vlerë të borxhit që i përmbushin kushtet për emetuesin dhe emetimin sipas kësaj rregulloreje, në rast të ofertës publike;
- ç) blejë dokumente për pjesëmarrje dhe të paraqesë kërkesë për shlyerjen e tyre drejtpërdrejt nga/te shoqëria që menaxhon fonde investuese të hapura, të lëshuara nëpërmjet ofertës publike; dhe
- d) blejë dokumente për pjesëmarrje dhe të paraqesë kërkesë për shlyerjen e tyre drejtpërdrejt nga/te një shoqëri që menaxhon me fondet investuese private, të lëshuara nëpërmjet ofertës private.

Neni 5

Tregtimi sekondar me letra me vlerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryhet nëpërmjet bursës dhe tregut nëpërmjet sportelit të organizuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me ligjin.

Tregtimi sekondar me instrumente financiare jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut kryhet në tregje të rregulluara të instrumenteve financiare, në përputhje me ligjin. Gjatë kësaj, duhet të plotësohen kushtet në vijim:

- a) instrumentet që tregtohen në tregjet e rregulluara duhet të jenë të listuara paraprakisht në bursën e një shteti anëtar të BE-së ose të OECD-së;
- b) marrëveshja për tregtimin me aksione ose pjesëmarrje në fonde investive duhet të jetë e nënshkruar me të paktën një ndërmjetës tregu që siguron tregtim me çmime që nuk devijojnë ndjeshëm nga çmimi i bursës i aksioneve ose i pjesëve të fondit investiv në të cilin investohet, përkatësisht nga vlera neto e aseteve të fondit investiv; dhe
- c) shtëpia tregtare që kryen tregtimin në tregun jashtë bursës duhet të ketë kapital mbi 200 milionë euro.

III. b) Cilësia e instrumenteve dhe shteteve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale

Neni 6

Shoqëria që menaxhon fondin pensional është e detyruar, gjatë marrjes së vendimit për investimin e mjeteve të fondit pensional, të marrë parasysh aspektet e mëposhtme:

- a) Sigurimin e informacionit të saktë, të rëndësishëm, të plotë dhe të përditësuar rregullisht. Shoqëria që menaxhon fondin pensional duhet të ketë informacione të mjaftueshme që të vlerësojë rreziqet dhe mundësitë e instrumentit dhe në bazë të tyre, të marrë vendim për investim që do të jetë në interesin më të mirë të anëtarëve të fondit pensional;
- b) Investimi i mjeteve të fondit pensional në instrumentin përkatës duhet të jetë në përputhje me parimet, qëllimet afatgjata dhe strategjinë e investimit të fondit pensional dhe me dokumentin për mënyrën e zbatimit të strategjisë së investimit për 12 muajt e ardhshëm;
- c) Rreziqet që dalin nga investimi në instrument duhet të përfshihen në sistemin e menaxhimit të rreziqeve të fondit pensional; dhe
- ç) Likuiditeti i instrumentit nuk duhet të rrezikojë aftësinë e fondit pensional që t'i përmbushë detyrimet e tij, duke pasur parasysh edhe kostot, me qëllim ruajtjen e vlerës së fondit pensional.

Neni 7

Mjetet e fondeve pensionale mund të investohen në instrumente të një personi juridik i cili ka raport për revizionin e kryer në raportet financiare vjetore, në të cilin nuk është shprehur përmbajtje nga mendimi apo mendim negativ për vitin e fundit financiar, në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të revizionit.

Neni 8

Mjetet e fondeve pensionale mund të investohen në dokumente të pjesëmarrjes në fonde investuese të hapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat kanë miratim nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe nëse themeluesi i shoqërisë që menaxhon fondin investues të hapur ose vetë shoqëria që menaxhon fondin investues të hapur ka përvojë të vazhdueshme prej minimum dy vitesh në menaxhimin e mjeteve në pronësi të palëve të treta.

Neni 9

Mjetet e fondeve pensionale mund të investohen në obligacione dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga qeveritë e huaja dhe bankat qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Europian ose të OECD-së, nëse shteti i emetuesit të obligacioneve dhe letrave të tjera me vlerë ka një vlerësim kreditor afatgjatë për borxhin e jashtëm në valutë të huaj të rekomanduar për investim sipas Standard & Poor's ose Moody's (Long-term Issuer Rating – Foreign) ose Fitch Investor Service (Long-term Issuer Default Rating – Foreign).

Neni 10

Mjetet e fondeve pensionale mund të investohen në letra me vlerë të borxhit të lëshuara nga kompani ose banka të huaja joshtetërorenga shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-së, nëse:

a) Letrat me vlerë të borxhit kanë vlerësim kreditor afatgjatë për borxhin e jashtëm në valutë të huaj të rekomanduar për investim sipas Standard & Poor's ose Moody's (Long-term Issuer Rating – Foreign) ose Fitch Investor Service (Long-term Issuer Default Rating – Foreign);

b) Janë lëshuar nga kompani ose banka të regjistruara dhe me seli në një shtet anëtar të BE-së ose OECD-së;

c) Vlera nominale e emetimit nuk është më e vogël se 100 milionë euro; dhe

ç) Shteti i emetuesit të letrave me vlerë të borxhit ka një vlerësim kreditor afatgjatë për borxhin e jashtëm në valutë të huaj të rekomanduar për investim sipas Standard & Poor's ose Moody's (Long-term Issuer Rating - Foreign) ose Fitch Investor Service (Long-term Issuer Default Rating - Foreign).

Mjetet e fondeve pensionale vullnetare mund të investohen në letra me vlerë të borxhit të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale të shteteve anëtare të BE-së ose OECD-së, nëse i përmbushin kriteret e paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 11

Mjetet e fondeve pensionale mund të investohen në aksione të kompanive ose bankave të huaja, të cilat tregtohen në bursat e vendeve anëtare të BE-së ose të OECD-së, nëse:

a) Aksionet janë të listuara në tregun zyrtar të bursave që përmbushin kushtet e nenit 5 të kësaj rregulloreje;

b) Janë lëshuar nga kompani të regjistruara dhe me seli në një shtet anëtar të BE-së ose të OECD-së;

c) Kompania që lëshon aksionet ka kapitalizim të tregut prej minimum 100 milionë eurosh;

ç) Kanë vlerësim kreditor afatgjatë për borxhin e jashtëm në valutë të huaj, i rekomanduar për investim sipas Standard & Poor's, Moody's (Long-term Issuer Rating - Foreign) ose Fitch Investor Service (Long-term Issuer Default Rating - Foreign) dhe

d) Shteti i kompanisë emetues i aksioneve ka një vlerësim kreditor afatgjatë për borxhin e jashtëm në valutë të huaj të rekomanduar për investim sipas Standard & Poor's ose Moody's (Long-term Issuer Rating - Foreign) ose Fitch Investor Service (Long-term Issuer Default Rating - Foreign).

Neni 12

Mjetet e fondeve pensionale mund të investohen në dokumente për pjesëmarrje, aksione dhe instrumente të tjera të fondeve të huaja të investimeve, nëse:

a) Shoqëria që menaxhon mjetet e fondeve të huaja të investimeve i plotëson kushtet e mëposhtme:

Ka të paktën tre vjet përvojë të vazhdueshme në menaxhimin e mjeteve në pronësi të palëve të treta;

- Ka seli në një shtet anëtar të BE-së ose të OECD-së, që nuk mund të jetë zonë off-shore;

- Menaxhon mjete në pronësi të palëve të treta në vlerë prej minimum një miliardë eurosh.

b) Fondet e huaja të investimeve plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Shteti ku është regjistruar fondi i investimeve ka vlerësim afatgjatë krediti për borxhin e jashtëm në valutë të huaj, i rekomanduar për investim sipas Standard & Poor's, Moody's (Long-term Issuer Rating - Foreign) ose Fitch Investor Service (Long-term Issuer Default Rating - Foreign);

- Vlera neto e mjeteve të fondit të investimeve është minimum 100 milionë euro;

- Minimum 51% e mjeteve të fondit të investimeve janë investuar në instrumente që tregtohen në bursat e vendeve anëtare të BE-së ose OECD-së;

- Nuk ka karakteristika të një hedge fondi, domethënë nuk është një fond privat me kapital rreziku.

IV Transferimi i menaxhimit me mjetet e një fondi pensional te menaxheri i mjeteve me seli jashtë shtetit.

Neni 13

Kur shoqëria që menaxhon fondin pensional investon jashtë shtetit nëpërmjet menaxherit të fondeve me seli jashtë shtetit, personi juridik të cilit mund t'i besohet menaxhimi i mjeteve të fondit pensional duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) Të jetë person juridik dhe të ketë autorizim ligjor për menaxhimin e mjeteve të palëve të treta sipas legjislacionit të shtetit të origjinës;

b) Mjetet e menaxherit të fondeve me seli jashtë shtetit të jenë të ndara tërësisht nga mjetet e menaxhimit në pronësi të palëve të treta;

c) Të menaxhojë mjete në pronësi të palëve të treta në vlerë prej minimum 20 miliardë eurosh;

ç) Të ketë minimum shtatë vjet përvojë të vazhdueshme në menaxhimin e mjeteve në pronësi të palëve të treta;

d) Të jetë i regjistruar në Regjistrin e veçantë për menaxherët e fondeve me seli jashtë shtetit (në tekstin në vijim: Regjistri i menaxherëve) pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Shoqëria që menaxhon fondin pensional duhet të dorëzojë të dhëna për menaxherin e fondeve tek Agjencia, me të cilat konfirmohet se janë përmbushur kushtet e paragrafit (1) të këtij neni, para se t'i besojë menaxhimin e mjeteve të fondit pensional menaxherit të fondeve me seli jashtë shtetit. Agjencia refuzon regjistrimin e menaxherit të fondeve me seli jashtë shtetit në Regjistrin e menaxherëve, nëse nuk janë përmbushur kushtet e paragrafit (1) të këtij neni ose nëse konstaton se regjistrimi është në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional.

Shoqëria që menaxhon fondin pensional nuk mund të investojë jashtë shtetit nëpërmjet menaxherit të fondeve me seli jashtë shtetit, i cili nuk është regjistruar në Regjistrin e menaxherëve.

Shoqëria që menaxhon fondin pensional njofton Agjencinë për ndryshimet lidhur me kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, për menaxherin e huaj të fondeve.

V. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 14

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse do të fillojë të zbatohet nga 1.10.2025.

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja për investim të mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 134/2010, 99/2011, 75/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 274/2021 dhe Rregullorja për investim të mjeteve të fondeve vullnetare pensionale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 171/2010, 75/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 274/2.021).

Nr. 01-852/6
1.7.2025
Shkup

Këshillit të ekspertëve,
Kryetar,
Remzi Bajrami, d.v.